



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1002 prot.

Tiranë, më 30. 06. 2021

V E N D I M

Nr. 123, datë 30. 06. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 50, datë 31.03.2021, të R. H., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”¹, “*përkatësisë në një grup të veçantë*”² dhe “*çdo shkak tjetër*”³ nga ana e Bashkisë Berat.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shtetasi R. H. në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit të tij, Bashkia Berat, duke e larguar nga puna. Mbështetur në aktet e vëna në dispozicion bashkëngjitur ankesës, R. H. pretendon se nga data 27.10.2015, deri më datë 20.01.2017, ka ushtruar funksionin e Këshilltarit të Kryetarit të Bashkisë Berat. Më datë 20.01.2017, ankuesi është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Ndërmarrjes së Gjelbërimit të Bashkisë Berat, pozicion të cilin e ka mbajtur deri më datë 05.02.2019, kur është emëruar Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Elektrikut në këtë ndërmarrje. Pozicionin e Përgjegjës të Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Elektrikut, ankuesi e ka ushtruar deri më datë 20.09.2019, kur është larguar nga puna me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat.

¹ Referuar kartës së anëtarësisë nr. G.....C dhe vërtetimit datë 19.03.2021 të lëshuar nga Partia Demokratike, Dega Kuçovë, R. H. është anëtar i subjektit politik: Partia Demokratike, që nga viti 1991.

² Referuar Pasaportës me Nr., ankuesi është shtetas Amerikan.

³ Në rastin konkret ankuesi nuk ka përcaktuar një karakteristikë apo veçanti që mbart dhe që prezumohet që ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar.

⁴Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

Sipas ankuesit, në 4 vite që ai ka ushtruar detyra të ndryshme pranë Bashkisë Berat, ndaj tij nuk është marrë asnjë masë disiplinore apo vërejtje. Ankuesi pretendon se menjëherë pas emërimit të Kryetarit të Bashkisë Berat, E. D., në zgjedhjet vendore të vitit 2019, ndaj tij ka nisur një sulm politik, për shkak se ai është anëtar i subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, që prej themelimit të saj. Sapo E. D. dhe Zëvendëskryetari i Bashkisë Berat janë emëruar në detyrë, atij i është thënë prej tyre: “*kriminal i PD-së*”.

Përsa më sipër, ankuesi sqaron se largimi i tij nga puna nuk lidhet me faktin që arsimi i tij nuk përputhet me pozicionin e kërkuar siç është cituar në urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, por me bindjet politike dhe nënshtetësinë amerikane të tij.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Bashkisë Berat, për shkaqet sipërcituara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 543/2 prot., datë 07.04.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues⁵ Bashkisë Berat, lidhur me pretendimin e ankuesit.

⁵ - Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.
- Kopje e vlerësimeve të punës të subjektit ankues për tre vitet e fundit, nëse ka.
- Kopje të strukturës organizative të Bashkisë Berat, në momentin e largimit nga puna të ankuesit.
- Një kopje e dosjes personale të ankuesit.

Nëpërmjet shkresës⁶ me nr. 1914/1 prot, datë 15.04.2021, Bashkia Berat ka dërguar parashtrimet e veta dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...Ankuesi R. H. ka qënë i punësuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Berat në pozicionin Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve, Trotuare dhe Ndriçimit Publik. Këtë pozicion e ka mbajtur deri në shkëputjen e marrëdhënieve të punës më datë 16.09.2019 me motivacionin ‘Mospërputhje e llojit të diplomës me diplomën e kërkuar sipas strukturës’. Me shkresën nr. 4599 prot., datë 06.09.2019 ‘Njoftim për fillimin e procedurave për zgjidhje të kontratës së punës’ ankuesi është njoftuar sipas neneve 141, 144 të Kodit të Punës për diskutimin mbi kontratën e punës.

Më datë 10.09.2019 në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore është zhvilluar takimi ndërmjet ankuesit dhe specialistëve të drejtorisë, ku është mbajtur proces verbal i firmosur nga palët. Në këtë proces verbal ankuesi ka shprehur edhe qëndrimin e tij në lidhje me motivacionin ‘Mospërputhje e llojit të diplomës me diplomën e kërkuar sipas strukturës’. Në këtë proces verbal ankuesi nuk ka ngritur pretendime të diskriminimit për arsytet e përmendura në ankesë. Me Urdhërin nr.650, datë 16.09.2019, R. H. me pozicion pune ‘Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve, Trotuare dhe Ndriçimit Publik’, lirohet nga detyra me motivacionin ‘Mospërputhje e llojit të diplomës me diplomën e kërkuar sipas strukturës’. Marrëdhëniet juridike dhe financiare të punës do të përfundojnë në datë 20.09.2019.

Pretendimet e cituara në ankesë janë të pabazuara në fakte dhe prova pasi vetë ankuesi është i paqartë në pretendimet e tij pasi citon faktin se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër...

Përsa i përket punonjësve të tjerë që janë larguar me të njëjtin motivacion ka qënë punonjësi K. ZH. në pozicionin ‘Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale’ në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, të cilit i janë shkëputur marrëdhëniet e punës me motivacionin ‘Mospërputhje e llojit të diplomës me diplomën e kërkuar sipas strukturës’...

Në pozicionin që ka mbajtur ankuesi kanë qënë të emëruar punonjësit Ll. H. me arsimimin Inxhinier Mekanik dhe Elektrike dhe punonjësi R. S. me arsimimin Inxhinier i Agromjedisit...

Pretendimet për diskriminim në ankesë janë absurde dhe të pabazuara në prova pasi punonjësi në asnjë rast nuk është diskriminuar për shkaqet e përmendura. Në Bashkinë Berat mund të ketë punonjës që aderojnë në forca të ndryshme politike. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë anëtarë të të njëjtës forcë politike që pretendon se aderon ankuesi, dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Bashkia Berat gjithmonë ka siguruar të drejtën e punonjësve për barazi përpara ligjit dhe trajtim të barabartë për çdo punonjës. Në asnjë rast nuk është ushtruar presion ose veprim diskriminues, por çdo veprim është kryer në kuadër të punës dhe mirëfunksionimit të

-
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit (akti i largimit), nëse ka patur punonjës të tjerë të Bashkisë Berat, me të cilët janë ndërprerë marrëdhëniet e punës si rezultat i mospërputhjes së llojit të diplomës me diplomën e kërkuar sipas strukturës.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit (akti i emërimit dhe arsimimi i tij/saj), nëse ka patur punonjës të emëruar në pozicionin që ka mbajtur më parë ankuesi.
 - Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 543/3 prot., datë 19.04.2021

detyrave dhe përgjegjësi të bashkisë. Në dosjen personale të ankuesit e cila ndodhet në drejtorinë përkatëse nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se ankuesi aderon në ndonjë forcë politike...”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga ankuesi, me objekt, dëmshpërblimin si rezultat i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës; mosrespektim i procedurave të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës etj.; Komisioneri vlerëson se ky është një pretendim që do të trajtohet nga organet gjyqësore dhe jo nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga ana e punëdhënësit, Bashkisë Berat, për shkak të bindjeve politike dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues ka nisur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Berat, në datën 01.10.2015, në detyrën e Nëndrejtorit të Konviktit. Më pas me datë 27.10.2015, rezulton se ankuesi ka ushtruar detyrën e Këshilltarit të Kryetarit të Bashkisë. Me Urdhrin Nr. 116, datë 04.02.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat, është emëruar në pozicionin e Përgjegjës të Mirëmbajtjes së Rrugë, Trotuare dhe Ndriçim Publik, në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Bashkisë Berat.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Berat u zgjodh E. D., mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Me emërimin e E. D. në krye të Bashkisë Berat, ka nisur verifikimi i përputhshmërisë së arsimit në pozicionet e punës së punonjësve të Bashkisë Berat. Në këtë kuadër, Drejtoria e Shërbimeve Publike, me shkresën Nr. 464 prot., datë 02.09.2019, ka përcjellë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Publikun dhe Juridike, dosjet e personelit të tre drejtuesve si më poshtë:

- z. R. H., me pozicion pune “Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugë, Trotuare dhe Ndriçim Publik”;
- z. K. ZH., me pozicion pune “Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale”;
- z. F. M., me pozicion pune “Drejtor”.

Nga verifikimi i dosjeve të punonjësve të sipërcituar, Bashkia Berat ka konstatuar se ankuesi me arsim Agronom i Lartë dhe Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, shtetasi K. ZH, me arsim Shkenca Juridike, kishin mospërputhje të llojit të diplomës me arsimin e kërkuar për pozicionet respektive të punës. Në këtë kuadër, nga ana e Bashkisë Berat, është nisur procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin dhe punonjës K. ZH.

Me anë të shkresës Nr. 4599 prot., datë 06.09.2019, Bashkia Berat ka njoftuar ankuesin për fillimin e procedurave për zgjidhje të kontratës së punës, me arsyetimin “mospërputhje e llojit të diplomës me diplomën e kërkuar sipas strukturës së miratuar”.

Në nenin 144/1 të ligjit 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet : “1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të.”. Sa më sipër, njoftimi i është komunikuar subjektit ankues më datë 06.09.2019 dhe është lënë takim për diskutimin e marrëdhënieve të punës më datë 10.09.2019.

Pika 2 dhe 3 e nenit 144, të Kodit të Punës parashikon se: “...2. Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë dhe i jep atij mundësi për t’u shprehur.

3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operationale të ndërmarrjes....”.

Referuar këtij parashikimi, më datë 10.09.2019, është mbajtur takimi për diskutimin e marrëdhënieve të punës mes ankuesit dhe punëdhënësit të tij. Nga procesverbali i nënshkruar nga palët, rezulton se ankuesi është vënë në dijeni lidhur me arsyet e fillimit të procedurave për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës dhe ndër të tjera ka cituar se: “...Unë jam Përgjegjës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike dhe organizoj punën me puntorët dhe çdo punë tjetër në terren. Deri ditën e sotme nuk kam marrë asnjë vërejtje për punën e bërë. Jam në dijeni të faktit se nuk zotëroj diplomën e inxhinierit, por më është ngarkuar kjo, pasi kam patur eksperiencë nga puna si Drejtor i Drejtorisë së Gjelbërimit, Bashkia Berat. Në momentin e fillimit të punës më është thënë se do punoni në këtë pozicion pasi nuk kemi mundur të gjejmë punonjës për këtë pozicion me diplomë Inxhinieri. Kam katër vjet që punoj në Bashkinë Berat në disa pozicione pune të ndryshme, si Nëndrejtor Konvikti, Këshilltar pranë Kryetarit për Bujqësinë dhe Pushtetin Lokal, Drejtor i Drejtorisë së Gjelbërimit dhe së fundmi në pozicionin aktual. Kërkoj të mos largohem nga puna por të pozicionohem në një vend tjetër në Bashkinë Berat në përputhje me arsimin përkatës...”.

Mbështetur në nenin 64, pika g), të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ku citohet se: “Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:...emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësisive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;...”, Kryetari i Bashkisë Berat, me Urdhër Nr. 650, datë 16.09.2019, ka vendosur shkarkimin e ankuesit nga detyra që mbante, me motivacionin: “Mospërputhje e llojit të diplomës me diplomën e kërkuar sipas strukturës së miratuar”.

Referuar provave të vëna në dispozicion, e njëjta procedurë për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për shkak të mospërputhjes së diplomës me arsimin e kërkuar për pozicionin e punës që mbante, është ndjekur edhe për Përgjegjës tjetër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, shtetasin K. ZH.

Në analizë të strukturës së administratës së Bashkisë Berat dhe të njësisive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat për vitin 2019, miratuar me Vendimin Nr. 925, datë 26.11.2018, rezulton se, Drejtoria e Shërbimeve Publike përbëhet nga 3 (tre) pozicione Përgjegjës, përkatësisht: Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugë, Trotuare dhe Ndriçim Publik; Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale dhe Përgjegjës Mekanik.

Referuar arsimin të kërkuar për pozicionet: Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugë, Trotuare dhe Ndriçim Publik dhe Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, në strukturën organizative

kërkohej **Arsim i Lartë/Inxhinier Ndërtimi**, ndërsa për pozicionin Përgjegjës Mekanik kërkohej Arsimi i Lartë, **Inxhinier Mekanik**.

Përsa më lart dhe në analizë të situatës së ankuesit, Komisioneri konstaton se Bashkia Berat pasi ka konstatuar faktin që ankuesi nuk disponon arsimin e kërkuar për pozicionin e Përgjegjës të Mirëmbajtjes së Rrugë, Trotuare dhe Ndriçim Publik, ka ndërmarrë procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me motivacionin e mospërputhjes së arsimit të tij me atë të kërkuar për këtë pozicion pune.

Mbështetur edhe në provat e administruara nga palët në proces, Komisioneri konstatoi faktin se veç subjektit ankues, për të njëjtin motivacion është larguar edhe punonjësi K. ZH., i cili mbante pozicionin Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale. Pra, referuar faktit që ankuesi dhe punonjësi tjetër K. ZH., kanë qënë në të njëjtat kushte, emëruar në pozicionet përkatëse të punës jashtë kriterëve arsimore të kërkuara, edhe largimi i tyre nga detyra është bërë në të njëjten mënyrë.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Bashkia Berat, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Berat, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit R. H., në të drejtën për punësim, për shkaqet e pretenduara prej tij, nga ana e Bashkisë Berat.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)